



Ulpiana Neighborhood | Zija Shemsiu Str | No. 34 | Dobri Doj | 10000 | Kosovo
T: 038 763 000 | F: 038 700 001 | E: office@ipko.net | W: www.ipko.com

KOLEGJI UNIVERSUM

PRISHTINË

21789 dt. 17.10.2025

UNI **Universum**
International College
Powered by Arizona State University

SEKRETI TREGTAR: NIVELI I MESËM

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

Ky Memorandum Bashkëpunimi është lidhur dhe dakorduar më 17.10.2025, ndërmjet:

IPKO Telecommunications L.L.C, me numër unik identifikues 810485301, me seli në Zija Shemsiu 34, Prishtinë, përfaqësuar nga Arta Koka Grubi, në cilësinë e Drejtoreshës së Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve (në vijim referuar si "IPKO" dhe/apo "Kompania");

në njërën anë, ndërsa në anën tjetër,

UNI – Universum International College me numër unik identifikues 810640294, Prishtinë, përfaqësuar nga Arlinda Berisha-Qehaja, në cilësinë e Drejtoreshës Operative (në vijim referuar si "UNI");

Këtu e tutje, **IPKO** dhe **UNI**, bashkërisht referuar si Palët.

Palët janë dakorduar si vijon:

Neni 1

Qëllimi i Memorandumit

1.1 Ky Memorandum ka për qëllim të vendosë themelet dhe të zhvillojë një bashkëpunim të qëndrueshëm ndërmjet UNI-të dhe IPKO-së në fushat me interes të përbashkët, me fokus në ofrimin e mundësive për praktikë profesionale për studentët e UNI-të.

1.2 Ky bashkëpunim do t'i mundësojë IPKO-së të jetë pjesë e një rrjeti partnerësh strategjikë të UNI-të, duke kontribuar kështu në formimin profesional të të rinjve, identifikimin e talenteve të reja, promovimin e markës së saj, si dhe zhvillimin e fuqisë punëtore të së ardhmes.

Neni 2

Objektivat e Bashkëpunimit

2.1 Përmes këtij Memorandumi, Palët pajtohen të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:

2.1.1. Ofrimi i mundësive të praktikës profesionale për studentët e UNI-të në ambientet e IPKO-së;

2.1.2. Promovimi i IPKO-së si partnere e UNI-të përmes kanaleve zyrtare të komunikimit (faqe zyrtare, rrjete sociale, ngjarje, publikime) në përputhje me udhëzimet e shkruara të Kompanisë dhe rregullat e saj për promovimin dhe përdorimin e markës tregtare dhe emrin e Kompanisë;



2.1.3. Krijimi i mundësive për bashkëpunim në projekte konkrete të zhvillimit teknologjik, ku studentët e UNI-të mund të kontribuojnë dhe angazhohen, nën mentorimin e profesionistëve të Kompanisë.

Neni 3

Përgjegjësitë dhe Angazhimet e Palëve

3.1 Palët pajtohen që, përgjatë bashkëpunimit, të zbatojnë rregullat procedurale të të dyja subjekteve juridike, si obligime të vendosura në këtë Memorandum.

3.2 Palët garantojnë që bashkëpunimi të realizohet në pajtim me këtë Memorandum. Asnjëra Palë nuk ngarkohet me obligime të veçanta, përveç atyre që përcaktohen në këtë Memorandum.

3.3 Përgjegjësitë e UNI-të:

3.3.1 Të përzgjedhë dhe propozojë studentët për praktikë profesionale, në përputhje me kërkesat e dhe kriteret e përcaktuara të IPKO-së;

3.3.2 Të sigurohet që studentët e përzgjedhur për praktikë profesionale janë të informuar lidhur me rregullat, normat e etikës dhe sjelljen e pritur gjatë periudhës së praktikës;

3.3.4 Të promovojë IPKO-në si partnere strategjike në evente dhe komunikime publike, në përputhje me udhëzimet e shkruara të Kompanisë dhe rregullat e saj për promovimin dhe përdorimin e markës tregtare dhe emrin e Kompanisë;

3.3.5 T'i ofrojë Kompanisë listën e studentëve të dalluar dhe me potencial profesional për qëllime punësimi/angazhimi në Kompani.

3.4 Përgjegjësitë e IPKO-së:

3.4.1 Të pranojë studentët e përzgjedhur për praktikë, në përputhje me kapacitetet organizative dhe nevojat operationale të saj;

3.4.2 Të shqyrtojë mundësitë për angazhim të mëtijshëm të studentëve të dalluar pas përfundimit të praktikës, përmes mundësive të punësimit apo formave tjera të bashkëpunimit. Sidoqoftë, IPKO nuk mban obligim për punësim të studentëve pas përfundimit të periudhës së përvojës praktike nga ana e studentëve.

Neni 4

Kohëzgjatja

4.1. Ky Memorandum do të hyjë në fuqi në momentin e nënshkrimit të tij nga Palët dhe do të jetë në fuqi për një periudhë prej 1 (një) viti. Pas skadimit të afatit, Palët mund të vazhdojnë afatin e Memorandumit përmes nënshkrimit të një Aneksi, sipas pajtimit mes tyre.

Neni 5

Ndërprerja e Memorandumit

5.1 Palët bien dakord që secila prej tyre mund ta ndërpres këtë Memorandum duke i dhënë palës tjetër një periudhë njoftimi prej 30 (tridhjetë) ditësh.

5.2 Njoftimi i ndërprerjes do të përfshijë periudhën e ndërprerjes që do të fillojë të llogaritet në ditën kur njoftimi i ndërprerjes i është dorëzuar palës tjetër, përmes e-mail-it apo formave të tjera të shkruara të komunikimit.



5.3 Secila palë mund të ndërpres Memorandumin pa dhënë ndonjë periudhë të njoftimit në rast se pala tjetër pushon veprimtarinë afariste ose i nënshtrohet falimentimit apo ndonjë procedure tjetër të likuidimit.

Neni 6 **Fuqia Madhore**

6.1 Asnjëra palë nuk do të jetë përgjegjëse për ndonjë vonesë në kryerjen e detyrimeve të saj sipas kontratës nëse vonesa e tillë është shkaktuar nga fuqia madhore. Pala që nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e saj për shkak të fuqisë madhore, menjëherë do të njoftojë palën tjetër për një ngjarje të tillë të fuqisë madhore, ku njoftimi i mësipërm do të përfshijë arsyet e hollësishme të fuqisë madhore.

6.2 Fuqia madhore konsiderohet një ngjarje e paparashikuar dhe e papritur e cila nuk varet nga vullneti të palëve kontraktuese dhe palët nuk kanë qenë apo nuk duhet të jenë në gjendje të presin atë, të parandalojnë ato ose të shmangin atë.

Neni 7 **Konfidencialiteti**

8.1 Të gjitha dokumentet në lidhje me objektin e këtij Memorandumi do të konsiderohen konfidenciale. Çdo person, punonjës apo punëtorët tjerë të cilët kanë qasje në këto informata konfidenciale nuk do të zbulojnë këto informata ndonjë pale të tretë pa lejen shprehimore me shkrim të personit të autorizuar, përveç për personat që kanë nevojë të informohen sipas detyrës zyrtare ose personat të cilët janë të autorizuar për këtë arsye sipas legjislacionit të zbatueshëm.

8.2 Punonjësit e UNI-të, si dhe çdo person tjetër që UNI do të përfshijë në procesin e punës në bazë të këtij Memorandumi, do të jetë i obliguar për të mbajtur informacionin e IPKO-së si konfidencial, nëse ata e dinin ose duhet të ketë qenë në dijeni për natyrën konfidenciale të informatave, pavarësisht mënyrës në të cilën ata u njohën me informatën. UNI bie dakord të obligojë punonjësit e tij dhe personat tjerë të përfshirë në punë në pajtim me këtë Memorandum për mbajtjen e konfidencialitetit të përfshirë këtu.

8.3 Çdo informatë për të cilën është e qartë se zbulimi i saj personave të paautorizuar do të shkaktojë dëme serioze, po ashtu konsiderohet të jetë konfidenciale.

8.4 Nga personat e përmendur në paragrafin e parë dhe të dytë do të kërkohet për të mbajtur konfidencialitetin gjatë gjithë vlefshmërisë së kësaj kontrate, si dhe pas ndërprerjes të kësaj kontrate deri sa ato të mos trajtohen më si konfidenciale nga IPKO-së ose derisa ato të bëhen të disponueshme publikisht.

Neni 8 **Njoftimet dhe kontaktet**

12.1 Të gjitha njoftimet ose kërkesat e shkëmbyera nga palët gjatë ekzekutimit të këtij Memorandumi, do të realizohen përmes e-mailave zyrtarë.

Neni 9 **Ligji Qeverisës dhe Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

14.1 Ky Memorandum i nënshtrohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e zbatueshme të Kosovës.



14.2 Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale që mund të lindin gjatë zbatimit të këtij Memorandumi do të zgjidhen me mirëkuptim nga Palët. Në të kundërtën, çdo mosmarrëveshje do të jetë subjekt shqyrtimi nga Gjykata kompetente në Prishtinë.

Neni 10

Dispozitat Përfundimtare

16.1 Memorandumi përfaqëson të gjithë mirëkuptimin midis Palëve sipas lëndës së tij, dhe bashkon të gjitha diskutimet dhe negociatat paraprake mes tyre. Memorandumi mund të ndryshohet vetëm me shkrim.

16.2 Në rast se ndonjë dispozitë e këtij Memorandumi nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi, pavlefshmëria e tillë nuk do të ndikojë në dispozitat e mbetura të këtij Memorandumi. Palët do të arrijnë një Marrëveshje për dispozitat e reja që do të jenë në përputhje me legjislacionin dhe dispozitat në fuqi dhe të cilat do të ndjekin qëllimin e këtij Memorandumi.

16.3 Ky memorandum nuk krijon obligime ligjore ose financiare për asnjërën palë. Palët angazhohen në këtë bashkëpunim mbi baza vullnetare, në frymën e mirëbesimit, përfitimit të ndërsjellë dhe ndërtimit të një komuniteti profesional të qëndrueshëm.

16.4 Palët bien dakord që për të gjitha të drejtat dhe detyrimet e palëve që nuk rregullohen shprehimisht këtu do të zbatohen dispozitat e Ligjit për Detyrimet.

16.5 Memorandumi hyn në fuqi kur ajo është e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i secilës palë.

Ky Memorandum është hartuar në dy kopje identike, për palët dhe paraqet vullnetin e lirë dhe të plotë të palëve.

Për UNI-Universum International College

Arlinda Berisha-Qehaja
VP for Operations

Për IPKO Telecommunications L.L.C:

Arta Koka Grubi

Drejtoreshë e DBNjT

Prishtinë, 17.10.2025